



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE
ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE
SEKTORI I INTEGRITETIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ .06.2023

Lënda: Mbi kërkesën tuaj për informacion

Z. EDUARD HALIMI

Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 13

Tiranë

Në vijim të kërkesës suaj, datë 06.06.2023, protokolluar me tonën Nr. 3037, datë 07.06.2023, me anën e së cilës kërkon informacion për numrin e nëpunësve civil, të larguar nga funksioni dhe atyre që i'u është ndaluar emërimi në një pozicion, për shkak të zbatimit të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", si dhe në respektim të dispozitave të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Departamenti i Administratës Publike (DAP) ju bën me dije si më poshtë vijon:

Sikurse jeni në dijeni, bazuar në ligjin nr. 138/2015, i ndryshuar dhe vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, DAP është organi përgjegjës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil (*shkronja "gj", e pikës 4, të kreut II, të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë*).

Referuar pikës 1 dhe 3, të kreut II, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, subjektet që kandidojnë apo kërkojnë të zgjidhen/emërohen në një nga pozicionet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, në të njëjtën kohë me kërkesën për kandidim në funksionin publik, janë të detyruar që të depozitojnë edhe formularin e vetëdeklarimit, sipas formatit të përcaktuar në kreun III të këtij vendimi. Kur procedura e kandidimit, zgjedhjes apo emërimit nuk përfshin detyrimin për depozitimin e një kërkesë formale nga subjekti, atëherë organi kompetent e njofton atë që, brenda 10 ditëve nga njoftimi, të depozitojë të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, sipas këtij vendimi, me përjashtim kur parashikohet ndryshe me ligj. Në vijim, formulari i vetëdeklarimit përcillet zyrtarisht pranë organit përgjegjës DAP.

Në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, DAP në cilësinë e organit përgjegjës për administrimin e formularëve të vetëdeklarimit për subjektet e sa më lartë përmendur, pasi realizon procedurën paraprake të verifikimit të të dhënave të deklaruara nga këto subjekte dhe nëse evidenton se ato përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar apo përfshihen brenda periudhës së ndalimit, të përcaktuar në nenin 4, të këtij ligji, përcjell zyrtarisht rezultatet pranë institucionit përkatës, në të cilin kandidon apo është emëruar subjekti, i cili vijon me zbatimin e masave për pengimin e zgjedhjes ose emërimit apo largimit nga funksioni publik të personit. Masat e ndërmarra nga institucionet respektive përcillen zyrtarisht pranë DAP.

Sa më sipër, si dhe referuar të dhënave që DAP administron, bashkëlidhur lutemi gjeni numrin e nëpunësve civilë në administratën qendrore, institucionet e pavaruara dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të ndarë sipas viteve, të cilët janë liruar nga funksioni publik, pasi janë konstatuar në kushtet e ndalimit apo përjashtimit nga ky funksion, si dhe personave që i'u është ndaluar emërimi në një pozicion të shërbimit civil në administratën shtetërore, për të cilët DAP është njësi përgjegjëse, sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.